

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) dhe nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 69 të Ligjit 05/L-045 për sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2016 miratoi:

RREGULLORE PËR INVESTIMIN E ASETVEVE NË MBULIM TË PROVIZIONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE SI DHE INVESTIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë kategoritë e investimeve të aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, kufijtë maksimal të lejueshëm të investimeve lidhur me këto asete, si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve.
2. Fushëveprimi i kësaj rregulloreje mbulon të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm që ushtrojnë aktivitet në Kosovë dhe që janë të licencuar, rregullohen dhe mbikëqyren nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet.

Neni 3

Kufizime të përgjithshme

1. Siguruesit janë të detyruar të mbajnë asete të mjaftueshme në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike jo më pak se vlera bruto e provizioneve teknike, respektivisht matematike. Siguruesit duhet të sigurojnë shpërndarje adekuate të riskut lidhur me këto investime, si dhe të ndërmarrin veprime të nevojshme duke bërë vlerësimin e vazhdueshëm të tyre.
2. Asetet në emër të mbulimit të provizioneve teknike dhe matematike nuk mund të tërhiqen, investohen, tjetërsohen apo të lihen kolateral, përveç kur një ndalesë e tillë përjashtohet në mënyrë specifike me këtë rregullore.

Neni 4

Parimet e investimit të aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike

1. Investimi i aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike nga siguruesit duhet që në tërësi të plotësojnë kërkesat si në vijim:
 - a) asetet e investuara duhet të jenë mjaftueshëm të sigurta;
 - b) asetet duhet të jenë të investuara në atë formë që të jenë në gjendje të shlyejnë detyrimet ndaj të siguruarve në çdo kohë;
 - c) asetet duhet të mbahen në atë formë që të jenë të disponueshme në çdo kohë;
 - d) asetet e investuara duhet të jenë mjaftueshëm të diversifikuara.
2. Siguruesit duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se ata i përmbushin kërkesat rregullore për investime, si dhe kërkesat etjera të menaxhimit të rrezikut.
3. Asetet në mbulim të provizioneve teknike do të vlerësohen duke zbritur çdo detyrim që lidhet me këto asete.
4. Asetet në mbulim të provizioneve teknike do të vlerësohen në bazë të parimit të kujdesit të shtuar (maturisë) duke marrë për bazë të gjitha rreziqet e mundshme që lidhen me këto asete.

Neni 5

Kategoritë e aseteve të lejuara për mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike

1. Siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të cilët janë të licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar aktivitetet në fushën e sigurimeve në Kosovë mund të bëjnë mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike me kategoritë e aseteve të përcaktuara si më poshtë:
 - a) Depozita në valutë euro në banka të licencuara në Kosovë;
 - b) Bono thesari, obligacione dhe instrumente të tjera financiare të tregut të kapitalit, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me afat maturimi jo më shumë se një vit për siguruesit jojetë, ndërsa pa kufizim për siguruesit jetë;
 - c) Me kërkesën e veçantë të siguruesve dhe me miratimin paraprak të BQK-së, siguruesit mund të investojnë në instrumentet e përmendura në nënparagrafin b) të këtij paragrafi, të emetuara dhe të garantuara nga bankat qendrore dhe qeveritë e vendeve anëtare të BE-së, të cilat duhet të kenë klasifikim kreditorë jo më të ulët se BBB nga Standard & Poor's ose ekuivalentet e kësaj kategorie nga Fitch dhe Moody's, apo ekuivalentet e tyre të klasifikuara nga agjencionet e tjera të vlerësimit kreditor të njohura nga BQK-ja;
 - d) Po ashtu me aprovimin paraprak të BQK-së, siguruesi mund të investoj edhe në letra tjera me vlerë, të tregtuara në një treg të rregulluar, ku emetuesit e tyre janë të klasifikuara jo më pak se kategoria BBB nga Standard and Poor's ose ekuivalentet e kësaj kategorie nga Fitch dhe Moody's, apo ekuivalentet e tyre të klasifikuara nga agjencionet e tjera të vlerësimit kreditor të njohura nga BQK-ja;

- e) Pasuri të patundshme (toka, ndërtesa), si dhe mjete të tjera fikse të vlerësuara sipas normave të amortizimit;
 - f) Mjetet monetare në arkë, mjetet monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më pak se 3 muaj në bankat e licencuara nga BQK-ja në Republikën e Kosovës;
 - g) Kërkesat ndaj risiguruesve që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve, të cilat nuk janë më të vjetra se 90 ditë nga lindja e detyrimit.
 - h) Pjesa e risiguruesit në provizionet teknike;
 - i) Interesat e përlllogaritura (akruale) që rrjedhin nga investimet në depozita bankare dhe letra të tjera me vlerë;
 - j) Kërkesat ose llogaritë e arkëtueshme deri në 90 ditë, të cilat rrjedhin nga të siguruarit, agjentët dhe brokerët, por jo më shumë se njëzet përqind (20%) e rezervës për primin e pafituar bruto;
2. Asetet lidhur me provizionet teknike për rreziqet të cilat ndodhen në Kosovë, kërkohet që të mbahen në kujdestari brenda Kosovës. Ndërsa për asetet e investuara jashtë, siguruesit mund të sigurojnë shërbime të kujdestarit të investimeve në mënyrë, që të ofrojnë qasje në informacionet lidhur me këto investime.

Neni 6

Asetet të cilat nuk pranohen në mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike nga ana e siguruesve

1. Siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të cilët janë të licencuar nga BQK-ja për të ushtruar aktivitet në fushën e sigurimeve në Kosovë nuk mund të bëjnë mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike me kategoritë e aseteve si në vijim:
- a) Asetet të cilat shërbejnë për financimin e kapitalit të vetë siguruesit apo financimin e kapitalit të ndonjë subjekti tjetër, që është palë e ndërlidhur me siguruesin dhe që është objekt i kërkesave dhe kufizimeve nga rregullatori përkatës;
 - b) Letrat me vlerë të personave juridikë, të cilët janë subjekte të varura (filiale) të siguruesit, personave juridikë, që janë aksionarë të siguruesit apo çdo rast tjetër që konsiderohet si palë e ndërlidhur me siguruesin;
 - c) Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim dhe shpenzimet e parapaguara;
 - d) Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme me palë të ndërlidhura.
 - e) Huatë për brokerat dhe agjentët;
 - f) Llogaritë e tjera të arkëtueshme të cilat nuk rrjedhin nga veprimtaria e sigurimit;
 - g) Kërkesat lidhur me pagesat që rrjedhin nga rikuperimet dhe subrogimet;

Neni 7

Kufizimet e përcaktuara të investimit të aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike

1. Siguruesit të cilët ushtrojnë aktivitet në Republikën e Kosovës mund të investojnë asetet në mbulim të provizioneve teknike/matematike si në vijim:

- a) Pa kufizim në depozita në valutë euro në bankat e licencuara në Kosovë, mirëpo jo më shumë se tridhjetë përqind (30%) e investuar në një bankë të vetme;
 - b) Njëzet përqind (20%) në total të provizioneve teknike dhe matematike bruto të investuara në kategoritë e aseteve të përcaktuara me nenin 5, paragrafin 1, nënparagrafët c) dhe d) të kësaj rregulloreje. Investimi individual sipas nenit 5, paragrafin 1, nënparagrafin d), të emetuara nga një emetues i vetëm, nuk mund të kalojë pesë përqind (5%) të aseteve në mbulim të provizioneve teknike;
 - c) Njëzet përqind (20%) të provizioneve teknike bruto për siguruesit jo jetë, në total, kurse tridhjetë përqind (30%) të provizioneve teknike dhe matematike bruto në total, për siguruesit jetë, në toka dhe ndërtesa. Investimi individual nuk duhet të kalojë dhjetë përqind (10%) në çdo pjesë toke a ndërtese ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra-tjetrës që mund të vlerësohen efektivisht si një investim individual. Investimi në pasuri të paluajtshme është i pranueshëm nëse:
 - i. Pasuria e paluajtshme është e pajisur me dokumentacionin e nevojshëm, me të cilin pasuria është e regjistruar në kadastër në emër të siguruesit ose dokumentacionin i cili vërteton se kontrata e shitblerjes së pasurisë (apo parakontrata) është e vërtetuar tek noteri, si dhe pasuria është me leje ndërtimi nga organet kompetente;
 - ii. vlera e pasurisë së paluajtshme është përcaktuar nga vlerësuesi i licencuar i pavarur sipas standardeve përkatëse;
 - iii. pasuria gjeneron të hyra ose të hyra të pritshme;
 - iv. pasuria e paluajtshme nuk është lënë peng ose hipotekë, si dhe e njëjta nuk është ngarkuar në favor të një personi tjetër apo kur ajo mbahet nga një person tjetër.
 - v. siguruesi ka marrë aprovimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.
 - d) Njëzetepesë përqind (25%) e provizioneve teknike dhe matematike bruto nga detyrimet që rrjedhin nga risiguruesit, si dhe pjesa e risiguruesit në provizionet teknike nga neni 5, paragrafi 1 nën paragrafët g) dhe h). Përrjashtim nga ky kufizim bëjnë risiguruesit të cilët janë klasifikuar si BBB e më lartë nga Standard & Poor's ose ekuivalentet e kësaj kategorie nga Fitch dhe Moody's, apo ekuivalentet e tyre të klasifikuara nga agjencionet e tjera të vlerësimit kreditor të njohura nga BQK-ja;
 - e) Tre përqind (3%) e provizioneve teknike bruto nga kategoria e përcaktuar në nenin 5, paragrafi 1 nën paragrafi f);
 - f) Pesë përqind (5%) të provizioneve teknike bruto në asete fikse të ndryshme nga ato të përcaktuara në nën paragrafin c) të këtij neni;
 - g) Pesë përqind (5%) interesat e përlllogaritura në përputhje me nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi i);
2. Kufizimet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi b), nuk do të aplikohen për:
- a) bono dhe letra të tjera me vlerë borxhi të emetuara (lëshuara) nga Qeveria e Kosovës;

- b) bono dhe letra të tjera me vlerë borxhi të garantuara nga Qeveria e Kosovës.

Neni 8

Kapitali Themeltar (Fondi Garantues)

1. Kompanitë e sigurimeve të cilat operojnë në Republikën e Kosovës, me miratimin paraprak të BQK-së mund të investojnë kapitalin themeltar (Fondin Garantues) në kategoritë e investimeve si në vijim:
 - a) në bono dhe letra të tjera me vlerë borxhi të emetuara (lëshuara) nga Qeveria e Kosovës.
 - b) depozita në valutë euro në llogari të besueshme (escrow) në banka komerciale të licencuara në Kosovë, jo më shumë se 30% e mjeteve të depozituara në një bankë.
2. Siguruesit janë të obliguar që 10% të kapitalit themeltar në para të gatshme, ta depozitojnë dhe mirëmbajnë në çdo kohë në BQK.
3. Mjetet në emër të kapitalit themeltar do të jenë të paprekshme gjatë gjithë kohës dhe nuk mund të bëhet asnjë formë e lëvizjes, tërheqjes apo investimit të tyre pa aprovimin paraprak të BQK-së. Po ashtu mjetet e kapitalit themeltar nuk guxojnë në asnjë mënyrë të tjetërsohen apo të lihen peng.

Neni 9

Kufizimet në investime

1. Secili investim duhet të bëhet në emër të siguruesit apo të mbahet në emër të siguruesit apo kujdestarit të tij të investimit. Çfarëdo investime që nuk janë të regjistruara në këta emra nuk mund të përfshihen ose raportohen si investim në pasqyrat financiare të siguruesit.
2. Nëse BQK-ja konstaton se për shkak të kushteve të investimeve në përgjithësi apo për shkak të kushteve financiare ose praktikave aktuale të investimeve të siguruesit individual, interesi i të siguruarve, kreditorëve ose publikut është rrezikuar ose mund të rrezikohet, atëherë BQK-ja do të vendosë kufizime të arsyeshme dhe të përkohshme mbi investimet e një siguruesi individual, përfshirë këtu ndalesën apo kthimin e një investimi të caktuar.

Neni 10

Komiteti për Menaxhim të Investimeve

1. Bordi i drejtorëve i çdo siguruesi do të themelojë komitetin për menaxhim të investimeve, i cili përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë, prej të cilëve njëri duhet të jetë

anëtar joekzekutiv i bordit të drejtorëve. Anëtar i joekzekutiv duhet të jete kryesues i këtij komiteti.

2. Komiteti i investimeve takohet së paku 4 herë në vit (çdo tre muaj) dhe duhet t'i raportojë bordit të drejtorëve për:
 - a) sigurinë e investimeve si për nga kapitali ashtu edhe për nga të hyrat;
 - b) likuiditetin e investimeve dhe koordinimin e asetëve në dispozicion për t'i përballuar obligimet të cilat mund të dalin.
 - c) profitabilitetin e investimeve duke përfshirë një vlerësim nëse investimet janë mjaft profitabile për të mbuluar rritjen e detyrimeve të cilat dalin nga policat.
 - d) devijimi nga politikat e përgjithshme të investimeve, udhëzimet, planet, objektivat apo strategjitë dhe ndikimin financiar të këtyre devijimeve.
 - e) masat korrektuese të adoptuara për t'i kompensuar rezultatet e pafavorshme.
 - f) ndryshimet apo përmirësimi i planit të investimeve, objektiveve dhe strategjive, nëse paraqitet nevoja, si dhe ndikimi financiar i parashikuar i këtyre ndryshimeve apo përmirësimeve.
 - g) rekomandimet për politikat e investimeve sipas nevojës.

Neni 11

Politika e investimeve të siguruesit

1. Secili sigurues duhet të ketë të shkruar politikën e investimeve, e cila përshkruan në detaje llojet e investimeve, të cilat do t'i ndjekë siguruesi, si ndërlidhet kjo me nevojat e likuiditetit të siguruesit në të ardhmen, si dhe të jetë në pajtueshmëri me rregulloret e investimeve të BQK-së. Politika e investimeve duhet të aprovohet nga bordi i drejtorëve të siguruesit dhe të dorëzohet një kopje fizike e politikës në BQK.
2. Çfarëdo ndryshimi pasues në politikën e investimeve duhet të aprovohet nga bordi i drejtorëve të siguruesit dhe këto ndryshime duhet të dorëzohen me shkrim në BQK.
3. Të gjitha investimet e përvetësuara dhe të mbajtura sipas kësaj rregulloreje, do të jenë nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e bordit të drejtorëve të siguruesit dhe duhet që të gjitha investimet të autorizohen ose aprovohen nga bordi ose komiteti i investimeve në pajtim me delegimet, standardet, kufizimet dhe qëllimet e investimit të përshkruara nga bordi.
4. Bordi i drejtorëve të siguruesit do të pranojë, shqyrtojë dhe aprovonjë raporte tremujore të investimeve, në të cilat do të përfshihen listat e detajuara të të gjitha aktivitetëve investuese (përfshirë depozitat në llogari të besuara dhe paranë e gatshme) dhe kjo do të dokumentohet në procesverbalin e takimeve të bordit drejtues të aktivitetëve investuese janë pranuar dhe aprovuar nga bordi i drejtorëve të siguruesit.

5. BQK-ja mund të shqyrtojë raportin e investimeve dhe procesverbalin e takimeve të bordit drejtues dhe të ndërmarrë masa të caktuara sipas nevojës nëse është e domosdoshme.

Neni 12

Marrëveshja e kujdestarit të investimeve

Secili sigurues duhet të ketë një marrëveshje të shkruar kujdestarie me një institucion të kualifikuar, në rastet e investimeve jashtë Republikës së Kosovës, ku detajohen përgjegjësitë e kujdestarit dhe të siguruesit në lidhje me mbajtjen e investimeve fizike. Kjo marrëveshje duhet të aprovohet nga bordi i drejtorëve të kompanisë.

Neni 13

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje, do të jetë subjekt i masave administrative dhe dënimeve me gjobë siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore dhe Ligjin nr. 05/L-045 për sigurimet.

Neni 14

Dispozitat kalimtare

Siguruesit janë të obliguar të mbajnë asete në mbulim të provizioneve teknike, sipas afateve të përcaktuara si më poshtë:

- a) nga 1 janar 2017 deri më 31 dhjetor 2017 - 70%
- b) nga 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018 – 85%, dhe
- c) nga 1 janar 2019 deri më 31 mars 2019 - 100%.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 31 dhjetor 2016. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Investimin e Aseteve në Mbulim të Provizioneve Teknike dhe Matematike si dhe Investimin e Kapitalit Themeltar të Siguruesve e datës 1 mars 2016

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci